

ARDIAN MUHAJ

SKLLAVËRIA NË TERRITORET SHQIPTARE GJATË ANTIKITETIT TË VONË DHE MESJETËS SË HERSHME

Skllavëria përbën një dukuri të historisë botërore që ka prekur të gjithë kontinentet, ndonjëherë në të njëjtën kohë, apo njëri pas tjetrit.¹ Statusi i skllavit në shoqërinë romake ishte i tillë sa që nuk mjafton të thuhet se ishte statusi më i ulët shoqëror, pasi skllavi nuk konsiderohej as si pjesë e shoqërisë, por në të gjitha rastet edhe ligjërisht i bashkëngjitej kafshës së punës. Disa shekuj më vonë, ky status kishte mbetur i njëjtë, dhe skllavi vazhdonte të konsiderohej si një plaçkë apo mjet pune. Burimet e skllavërisë në Antikitet dhe Mesjetë ishin të shumta, por mbizotëronte skllavërimi si pasojë e luftërave dhe konflikteve të ndryshme. Çështja e skllavërisë ndër ilirët ka zënë një vend fare të pakët në studimet e autorëve të ndryshëm mbi historinë e trojeve të stërlashta shqiptare, megjithëse skllavëria në Antikitet ka qenë një nga institucionet më të rëndësishme të strukturës shoqërore e lidhur direkt me mënyrën e marrëdhënieve të prodhimit. Zhvillim dhe përmasa të tjera mori fenomeni i skllavërisë me nisjen e dyndjeve të popujve që jetonin jashtë kufijve të perandorisë romake, duke ndikuar drejtpërdrejt në gjendjen e popullsisë që më pas do të përballet me epokën e Mesjetës së Hershme.

Përkufizimi dhe evoluimi i statusit të skllavërive nga fillimet në Antikitetin e Vonë

Në mesin e studiuesve qofshin këta historianë, juristë, antropologë apo sociologë, çështja e përcaktimit të termave të ndryshëm të përdorur

¹ Claude Meillassoux, *Anthropologie de l'esclavage. Le ventre de fer et d'argent*, Paris: Presses Universitaires de France, 1986, f. 20. Autori më tej shton: «fenomeni i skllavërisë përfshihet brenda një kompleksi social dhe politik të një hapësire të konsiderueshme gjeografike. Dimensioni antropologjik ka kuptim vetëm në këtë kontekst, i cili në vetvete ka të bëjë me ekonominë dhe demografinë e tërësisë së popujve që e kanë njohur fenomenin, të atyre që janë robëruar dhe të atyre që kanë përfituar» *Po aty*, f. 21.

gjatë historisë së gjatë të skllavërisë për ta emërtuar atë ka ngjallur natyrisht edhe diskutime. Një pjesë e këtyre autorëve e mohojnë mundësinë e përcaktimit dhe të kuptimit qartë të fenomenit. Meillassoux, për shembull, mendon se të dhënat që disponojmë për shoqëritë antike nuk na garantojnë asnjë kriter që të mundemi të bëjmë një dallim të qartë mes skllavërive dhe të gjitha shtresave të tjera përbërëse të këtyre shoqërive.² Po në këtë linjë, Lauffer, pohonte se “ne sot nuk duhet dhe nuk kemi se si të përkthejmë termin greqisht *doulos* apo atë latin *servus* me *skllav*, mbasi termi i fundit pasqyron tepër skllavëri zezake moderne”. Sipas tij *skllavi* antik është një tip social tërësisht i ndryshëm.³

Nga ana tjetër, ka një rrymë që synon të krijojë një “përzierje metahistoike” e cila “i sfidon të gjitha parimet shkencore tradicionale”. Në një linjë me këtë është edhe ideja e mbështetur nga shkolla antropologjike anglo-amerikane që përkthen me fjalën *skllav* një shumësi të madhe statusesh dhe termash të cilat emërtojnë simbas tyre skllavin në shoqëritë afrikane.⁴ Mirëpo siç vëren M. I. Finley, në pikat thelbësore, këta, të cilët prej tyre konsiderohen si skllavër, janë shumë të ndryshëm nga skllavërit e antikitetit klasik apo të Amerikës.⁵

Fjala *servus* i është huazuar shqipës shumë herët, përpara shek. X kur mendohet të ketë përfunduar shndërrimi i tingullit *s* në *sh*, dhe vjen natyrisht që nga koha e sundimit romak. Prej *servus* shqipja ka krijuar simbas ligjeve fonetike fjalën *shërbyes*, *shërbej*, dhe *shërbëtor*. (*servus* > *shërbyes* > *shërbëtor*). Ndërsa emri *skllav* është emër i huazuar vonë në shqip dhe jo vetëm nuk e ka kaluar fazën e shndërrimit fonetik *s* > *sh* por as nuk është përdorur në barazimin *sllav* = *skllav*.

Statusi i skllavit në shoqërinë romake ishte i tillë sa që nuk mjafton të thuhet se ishte statusi më i ulët shoqëror, mbasi skllavi nuk

² *L'esclavage en Afrique précoloniale*, dix-sept études présentées par Claude Meillassoux, Paris: ed., Maspero, 1975, f. 20.

³ Siegfried Lauffer, «Die Sklavenerie in der griechisch-römischen Welt», in *XI^e Congrès international des Sciences Historiques*, Actes du Congrès, Rapports II. Antiquité, Stockholm: 1960, f. 81.

⁴ *Slavery in Africa: Historical and Anthropological Perspectives*, edited by: Susanne Miers, Igor Kopytoff, Madison: University of Wisconsin Press, 1977, F. 5-6, 11.

⁵ Moises Israel Finley, *Esclavage antique et idéologie moderne*, Paris: Les éditions de Minuit, 1981, f. 90. Autori në këtë rast përdor termin pseudo-skllavër për të dhënë idenë se një pretendim i tillë është i pabazë.

konsiderohej as si pjesë e shoqërisë, por në të gjitha rastet edhe ligjërisht i bashkëngjitej kafshës së punës. Kështu Varroni në mënyrë krejt të qartë thotë: “Tani do të tregoj se me çfarë mjetesh punohet toka. Disa, këto mjete i ndajnë në dy grupe: në njerëzit dhe në veglat e punës, pa të cilat nuk mund të punohet; të tjerët i ndajnë llojet e veglave në tre: zanorë, gjysmëzanorë dhe të heshtur. Në zanorë hyjnë skllëvërit, në gjysmëzanorë hyjnë qetë dhe në të heshtur - qerret.”⁶

Disa shekuj më vonë ky status kishte mbetur i njëjtë, dhe skllavi vazhdonte të konsiderohej si një plaçkë apo mjet pune. Në një ligj të perandorit Justinian, të 18 tetorit 532, drejtuar Joanit, prefektit të Ilirikut, thuhet “Duke iu përgjigjur pyetjes së kolegjit të avokatëve në Ilirik, përcaktojmë që ... emri familje duhet të nënkuptohet edhe si pasuri sepse edhe skllëvërit dhe sendet e tjera nënkuptohet se janë pasuri e çdo njeriu”.⁷

Varroni na bën me dije për praninë e një kategorie të vecantë të punësuarish në bujqësi të cilët i quan *obaerarii*, të cilët nuk i përfshin tek njerëzit e lirë dhe thekson se këta janë të shumtë në Azi, në Egjipt dhe në Iliri.⁸

Simbas Mommsenit, në Romë bashkësisë së njerëzve të lirë, i kundërvihej ajo e njerëzve jo të lirë të cilët ndodheshin nën pushtetin e të parëve. Përderisa këta njerëz jo të lirë konsideroheshin thjesht si sende, këta individë nuk ishin madje as objekt i të drejtës romake. Përkrah skllëvërve në Romë ekzistonte edhe një shkallë e ndërmjetme mes skllavërisë dhe lirisë që autori i quan gjysëm të lirë apo klientë. Gjysëm liria në vetvete ishte një ide hibride në të cilën shprehet gjendja e atyre

⁶ "instrumenti genus vocale et semivocale et mutum, vocale, in quo sunt servi, semivocale, in quo sunt boves, mutum, in quo sunt plaustra". M. Terentii Varronis, *De re rustica*, Manheim: Societas literata, 1781, lib. I, cap. 17.

⁷ *The Code of Justinian*, Translated by Samuel P. Scott, Cincinnati, 1932, lib. VI, titulli 38, tema 5. «Për kuptimin e fjalëve dhe të gjërave».

⁸ «Omnes agri coluntur hominibus seruis aut liberis aut utrisque: liberis, aut cum ipsi colunt, ut plerique pauperculi cum sua progenie, aut mercenariis, cum conducticiis liberorum operis res maiores, ut uindemias ac faeniscia, administrant, itaque quos obaerarios nostri uocitarunt et etiam nunc sunt in Asia atque Aegypto et in Illyrico complures.» Varron, *Economie rurale*, Texte établi, traduit et commenté par Jacques Heurgon, Paris: Association Bude, 1978, libri I, 17.

që, nga njëra anë, ishin të privuar nga e drejta e qytetarisë romake por nga ana tjetër ishin pjesë përbërëse e shtetit romak.

Burimet e gjysëm lirisë apo klientelës ishin kur një fëmijë lindte nga një lidhje jashtëmartesore e një gruaje patrice, ose më vonë të një gruaje romake⁹ dhe *deditio*, ose si pasojë e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Romës dhe përfaqësuesve të një qyteti të mundur, marrëveshje, sipas së cilës, qyteti i mundur ia delegon Romës sovranitetin e vet ashtu si edhe qytetarët dhe hyjnitë e veta. Në këtë mënyrë, në mjaft raste, autoritetet romake në varësi të kushteve dhe mundësive i kthenin qytetarët e zonave të pushtuara në skllavëri ose në gjendje gjysëm të lirë, ose në raste të tjera përfshiheshin në rrethin e popullatës romake, apo në një rast tjetër u jepej statusi i qytetarëve të një shteti të pavarur të lidhur me Romën përmes një marrëveshjeje.¹⁰ Për këtë arsye, simbas Tit Livit, praktika e *deditios* shoqërohej me dorëzimin e pengjeve, mbasi në secilin rast kemi të bëjmë me një marrëveshje që duhej respektuar nga të dy palët.¹¹

Në historinë e skllavërisë ka ekzistuar edhe forma e posedimit të skllavit në bashkëpronësi nga dy apo më shumë pronarë të ligjshëm. Gjendja e skllavërisë të cilët ishin në pronësi të më shumë se një personi nuk është e vështirë të përfytyrohet. Ishte pa dyshim një fatkeqësi më tepër për skllavin. Posedimi i skllavit në mes pronarëve të ndryshëm në të njëjtën kohë e bën edhe më të qartë faktin se skllavi në të tilla raste nuk ishte asgjë më tepër se sa një mjet pune. Që skllavi i tillë ishte në të gjitha aspektet ligjore më i afërt me një send apo kafshë se sa me një njeri, dokumentacioni jep dëshmi të qarta. Në Katalonjë në mjaft dokumente të kohës dalin shprehje të tilla, që një person ka në pronësi të vet “një të pestën e një arabi të quajtur faurel Dalguazer”, apo “gjysmën e një arabi tjetër të quajtur Adene”. Ka raste kur njëra palë në gjyq deklaroi se pala tjetër i ka borxh një sasi parash dhe disa qese bukë të tharë, “për pjesën që ka pasur në një skllav arab i cili ishte liruar”.¹²

⁹ Théodore Mommsen, *Le droit public romain*, t. VI, Ernest Thorin editeur, Paris: 1889, f. 59-60.

¹⁰ *Po aty*, f. 60-61.

¹¹ Tit Livi, *Ab urbe condita*, Leipzig, B.G. Teubner, 1880, lib. 22, 20, 11.

¹² Jacques Heers, *Esclaves et domestiques au Moyen Age dans le monde méditerranéen*, Paris: Fayard, 1981, f. 205.

Burimet e skllavërisë në Antikitët dhe Mesjetë

Institucioni i pengut është një nga institucionet më të lashta të njerëzimit. Që kur njerëzve u lindi nevoja për të bashkëpunuar e lidhur marrëveshje me njëri-tjetrin, lindi edhe nevoja për të garantuar zbatimin e marrëveshjeve të tilla. Në kohën e luftërave punike, në bazë të marrëveshjes së bërë mes Hanibalit dhe maqedonasve me aleatët e tyre, për ndihmë reciproke kundër Romës, kartagjenasit betoheshin se në rast se fitojnë kundër romakëve, në marrëveshjen e paqes do të kërkoheshin edhe ilirët që romakët i kishin marrë si peng nga Demetër Fari, në mënyrë që ky i fundit t'i qëndronte ujdisë së bërë me romakët.¹³ Sipas një historie të perandorit Konstantin I, edhe ky kishte qenë peng tek Diokletiani dhe Galeri. Në këtë kohë ai luftoi me guxim në Azi.¹⁴

Edhe në të drejtën zakonore shqiptare janë ruajtur gjurmë të përdorimit të pengut si garantim i një marrëveshjeje. Edhe pse në këtë rast pengu ka më tepër vlerë dhe domethënie simbolike nënkupton premtimin e palëve se do të pranojnë verdiktin e gjyqit popullor. Për këtë arsye, konsiderohet si fillim i pleqnimit apo i nisjes së procedurës gjyqësore kanunore dorëzimi i pengut nga palët në konflikt. Pengu në këtë rast, natyrisht që nuk është një rob, por thjesht një objekt që i përket palës së interesuar për të nisur procesin, si një kuti duhani, një sahat etj.

Tregtia e skllavëve ishte gjithashtu një burim i rëndësishëm që lulëzonte në raste luftërash dhe fushatash pirateske. Ato zona që nuk i plotësonin nevojat e tyre për skllavë përmes luftës apo piraterisë, i blenin ata. Straboni flet për këtë tregti me anë të së cilës që në kohët e hershme ilirët që banonin në zonat pranë Istrit furnizoheshin nga romakët, të cilët këmbenin skllavë, kafshë e lëkura, me verë, peshk të kripur dhe vaj.¹⁵

Luftërat megjithatë mbeten motivet më të shpeshta të robërimit. Në vitin 231 p.e.s ushtritë e Agronit të nxitura nga mbreti i Maqedonisë, Demetri II vendosën që të ndihmoheshin medionasit që mbaheshin të rrethuar nga etolët. Pesë mijë ilirë në njëqind anije, zbarkuan në afërsi të Medionës dhe sulmuan kampin etol, duke bërë shumë robër prej tyre, të

¹³ Polybii, *Historiae*, Stutgardiae: B.G. Teubner, 1905, lib.VII, 13-14.

¹⁴ Anonymi Valesiani, *Origo Costantini Imperatoris*, ed. Didericus Johannes Antonius Westerhuis, Campis, Bos, 1906, 2.

¹⁵ Strabonis, *Geographica*, lib. V, 1.

cilët i morën me vete bashkë me plaçkën e luftës. Edhe në kohën e Teutës, ardianët ndërmerrnin fushata të vazhdueshme ushtarake, ku në mesin e plaçkës së luftës zinin një vend të rëndësishëm edhe robërit. Pasi pushtoi me dredhi Finiqen, Skerdilajdi mori, një numër të madh robërish. I thirrur nga Teuta me urgjencë u arrit marrëveshja sipas së cilës, Skerdilajdi u kthente epirotëve qytetin e Finiqes si dhe të gjithë qytetarët e lirë të zënë robër prej tij kundrejt shpërblimit, ndërsa robërit që ishin skllavër si edhe gjithë plaçkën e mori me vete.¹⁶

Luftërat iliro-romake e ndryshuan ndjeshëm balancën e skllavërisë në tokat ilire. Një numër shumë i madh ilirësh u morën dhe u shndërruan në skllavër gjatë fushatave ushtarake, dhe po ashtu me humbjen e sovranitetit politik, popullsitë ilire dhe epirote ishin një burim i vlefshëm për furnizimin e pronarëve romakë me skllavër. Ilirët, të cilët, simbas Kurt Rufit nuk mund të mësoheshin të qëndronin në robëri, tashmë ishin detyruar të ishin të tillë.¹⁷

Skllavëria romake për ilirët ishte një plagë dhe fatkeqësi e tillë sa që përpara se të skllavëroheshin shpesh ata preferonin të vdisnin. Dion Kasi, rrëfen se si gjatë kryengritjes ilire të udhëhequr nga Batoja, forcat romake hasën në një rezistencë shumë të madhe për marrjen e një vendi të fortifikuar të quajtur *Arduba* nga ilirët e vendit, të cilët ndihmoheshin edhe nga gratë që ndodheshin në kështjellë, sepse këto, thotë autori, donin lirinë edhe kundër mendimit të burrave, pranonin të pësonin çdo gjë përpara skllavërimit, dhe bënë një betejë të ashpër. Mbas u mundën, burrat u dorëzuan, por disa prej tyre edhe ia dolën të arratisen e të shpëtonin, ndërsa gratë, pasi rrëmbyen fëmijët, disa u hodhën në zjarr, disa të tjera në lumë për të mos pësuar fatin e keq të skllavërisë.¹⁸

¹⁶ Polybii, *Historiae*, lib. II, 3, 4, 5, 6. (Polybii, *Historiae*, ed. L. Dindorfo, vol. I, Lipsiae, B. G. Teubneri, 1924).

¹⁷ Filipi i Maqedonisë “po i rregullonte fshehurazi të gjitha punët, me qëllim që të zinte në befasi athinasit, dhe po e mbante ushtrinë e vet në gatishmëri, sepse fiset e Ilirisë, që kishin një natyrë të egër dhe nuk mund të mësoheshin të qëndronin në robëri, po kryenin tani veprime me qëllim që të zhdoknin zgjedhën». Curtius Rufus, Quintus, *Historiarum Alexandri Magni Macedonis*, ed. René Pichon, S. Dosson. Paris: Hachette, 1916, lib. I, suppl. 5.

¹⁸ Dionis Casii Cocceiani, *Historia romana*, ed. Ludwig Dindorf; Johann Melber, Lipsiae: B. G. Teubneri, 1894, lib. LVI, 15.

Ndër burimet e skllavërisë mund të përmendim edhe skllavërimin për borxhe (*obnoxatio*). Simbas kësaj praktike borxhliu që nuk ia del të paguajë detyrimet e tij dhe duke mos pasur pasuri tjetër, detyrohet të dorëzojë veten si skllav tek huadhënësi dhe në se huadhënësit janë shumë, atëherë ai bëhet pasuri e tyre e pandashme.¹⁹ Ka ekzistuar edhe një burim tjetër i pazakontë skllavërie: skllavërimi vullnetar i vetë personit.²⁰

Çështja e skllavërisë ndër ilirët ka zënë një vend fare të pakët në studimet e autorëve të ndryshëm mbi historinë e trojeve të stërlashta shqiptare, megjithëse skllavëria në Antikitët ka qenë një nga institucionet më të rëndësishme të strukturës shoqërore e lidhur direkt me mënyrën e marrëdhënieve të prodhimit. Rendi skllavopronar që njohu lulëzimin e tij të plotë në shtetin romak, por që karakterizon gjithë zonën e Mesdheut në kohën antike, nuk i ka lënë pa influencuar edhe territoret e banuara nga ilirët dhe shoqërinë ilire.

Masa e përhapjes së skllavërisë në rastin e shoqërisë ilire nga autorë të veçantë është parë me të drejtë si një tregues i zhvillimit ekonomiko-shoqëror dhe si një tregues i masës së kalimit nga organizimi fisnor i bazuar në lidhjet e gjakut, në një stad më të sofistikuar, atë të organizimit klasor të shoqërisë. Simbas Ch. E. Welskopf, në kohën e zhvillimit të rendit skllavopronar në Mesdheun e shek. IV-III p.e.s pirateria ishte shprehje e nevojës gjithnjë e në rritje të ekonomisë skllavopronare për të siguruar mjetet e prodhimit, pra skllavërit.²¹

Nga ana e tij, A. Buda duke u mbështetur në këtë përfundim thekson se pirateria e për pasojë edhe kërkesa për skllavërit ishte një fenomen i

¹⁹ Një praktikë e tillë ka qenë përhapur në krejt zonën e Mesdheut e më gjerë. Shih, p.sh. për Spanjën e vonë antike, *Leges Visigothorum* (më tej: *Leg. Visig.*), V, 6, 5, në *Monumenta Germaniae Historica. Inde ab anno Christi quingentesimo usque ad annum Millesimum et quingentesimum*, Hannoverae et Lipsiae: Imprensis Bibliopolii Hanniani, 1902, vëll. I, f. 233.

²⁰ Natyrisht që është e vështirë të mendohet se mund të ketë pasur njerëz që të kenë parapëlqyer skllavërinë në vend të një jete të qetë e pa telashe, por në rast të një jete të trazuar dhe me vështirësi, duket se zgjidhja ka qenë e tillë. *Leg. Visig.*, V, 4, 10, në *Monumenta Germaniae Historica...*, vëll. I, f. 15, 220. «Quiucumque ingenuus, se vindi permiserit et pretium cum venditore partitus est, ut circumveniret emtorem, proclamans postea nullatenus audiatur; sed in ea, qua voluit, servitute permaneat».

²¹ Ch. E. Welskopf, *Die Produktionsverhältnisse im alten Orient und in der griechisch-römischen Antike*, Berlin Akademie Verlag: 1957, f. 289.

përgjithshëm mesdhetar i kohës dhe ishte tregues i tendencës për të gjetur burime të reja skllavërishe në dëm të popujve të tjerë, mbasi rrugët e skllavërimin të brendshëm ishin ngushtuar. Fakti se mbretëresha ilire Teuta, në kundërshtim me traditën e deriatëhershme të oborrit ilir lejoi edhe privatë të ushtronin këtë aktivitet, nuk duhet parë si një shprehje e një mendjelehtësie prej gruaje, siç e thotë Polibi, por dëshmi e zhvillimit të mëtejshëm të skllavërisë tek ilirët që po kalonin nga një formë skllavopronare kolektive në një formë më të zhvilluar e të diferencuar private.²²

Lidhur me çështjen e filleve të skllavërisë në shoqërinë ilire nuk mund të jepet një përcaktim i saktë. Simbas S. Islamit, në bazë të gjetjeve arkeologjike dhe analizimit të të dhënave materiale të inventarizuara në vendbanimet e fortifikuara, si dhe në varrezat tumulare, shoqëria ilire e shek. V p.e.s ishte tashmë një shoqëri me një diferencim të theksuar social, por që akoma nuk e njeht skllavërinë.²³ Mirëpo, sipas këtij autori, kjo gjendje ndryshon me zhvillimin e mëtejshëm ekonomik e shoqëror, dhe me lindjen e qyteteve. Dukja e qyteteve solli me vete jo vetëm ndryshime në strukturën ekonomike, por edhe në atë sociale. Qyteti vepron kështu si bartës i rendit të ri skllavopronar dhe si përçues i tij. Në këtë mënyrë, skllavëria fillon të përhapet edhe në zonat jashtë qyteteve, të cilat ishin më konservatore dhe i ruanin marrëdhëniet fisnore. Në mesin e shek. IV p.e.s jo vetëm qytetet por edhe shoqëria rurale ilire njeht marrëdhënie vartësie dhe shfrytëzimi në formën e një skllavërie të tipit helot.²⁴

Burimet historike tashmë fillojnë të flasin. Theopompi²⁵ përmend prospelatët e ardianëve, të cilët përfaqësojnë një popullsi të gjerë të

²² Aleks Buda, "Ilirët e jugut si problem i historiografisë", në *Kuvendi I i Studimeve Ilire*, Tiranë, 15-20 shtator 1972, vëll. I, Akademia e Shkencave e RPSH, Tiranë: 1974, f. 58-59.

²³ Selim Islami, "Shteti ilir, vendi dhe roli i tij në botën mesdhetare", në *po aty*, vëll. I, f. 88-89.

²⁴ Po aty, f. 93. Në fakt ky term edhe pse përdoret shpesh në punimet e autorëve, është një term i cili nuk ka mundur të përkthehet mbasi edhe vetë përmajtja apo statusi i mirëfilltë i kësaj kategorie nuk është ndriçuar akoma mirë.

²⁵ Vepra e Theopompi "Historia e skllavërisë" ka humbur. Të njëtin fat e ka pasur edhe komedia "Dulodidaskalos" e Ferekratit, i cili është bashkëkohës i Perikliut dhe me nostalgji e përkujton kohën kur nuk ka pasur skllavëri. Zef Mirdita, *Studime dardane*, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, f. 67.

varur.²⁶ Simbas tij, ardianët kishin nën sundimin e tyre rreth 300 mijë skllevër, të cilët ai i krahason me helotët e Spartës.²⁷ Numri që jep ky autor edhe pse duket i fryrë dëshmon për përmasat e këtij fenomeni dhe për faktin se bëhet fjalë për një masë popullsie mbi të cilën ushtrohej një shfrytëzim. Supozimi i C. Patch se këta prospelatë, tek ardianët nuk ishin tjetër veçse një popullsi e huaj trake e nënshtruar, simbas S. Islamit, është pak me gjasë.²⁸

Ky fenomen dëshmohej jo vetëm tek ardianët, por edhe tek dardanët. Në vitin 216 p.e.s. në kohën e luftërave punike, Filipi i Maqedonisë u pozicionua kundër Romës dhe për këtë ngriti akejtë kundër romakëve. Mirëpo, ndërkohë dardanët filluan të shkretojnë tokat maqedonase dhe morën me vete njëzetmijë robër, gjë që e detyroi Filipin të tërhiqej nga lufta kundër romakëve duke e vënë përballë domosdoshmërisë për të mbrojtur mbretërinë e vet.²⁹ Agatharkidi që ka shkruar nga fundi i shek. II p.e.s thotë se dardanët kishin një numër të madh skllevërisht, (δουλοι i quan ai), disa njëmijë, disa edhe më tepër, të cilët në kohë paqeje punonin tokën, ndërsa në kohë lufte shkonin pas zotërve të tyre në fushata.³⁰

Mbi statusin e këtyre skllevërve nuk dihet në se ngjasonin me prospelotët e ardianëve, edhe pse ka shumë mundësi që të ketë qenë kështu. S. Islami, mendon se, edhe emri i fisit ilir të Penestëve, që kujton popullsinë e varur të Thesalisë të cilësuar me të njëjtin emër, tregon se edhe kjo popullsi ilire, i përkiste kategorisë së prospelatëve, dhulëve, apo helotëve.

Në këtë rast, dëshmia e Atheneut që thotë se “thesalët quajnë penestë jo ata që lindin skllevër, por ata që shtihen në dorë me anë të luftës”,

²⁶ Theopompi, simbas *Athenaei Deipnosophistae*, e recognitione Augusti Meineke, vol. I, lib. VI, Leipzig: B.G. Teubner, 1858, 101; 103; 85. Fjala që përdor Theopompi është προσπελάτις. F. W. Walbank, mbështet mendimin e M. I. Finley se skllavëria e këtij tipi është e ndryshme nga skllavopronaria. M. I. Finley, *Slavery in classical antiquity*, Cambdridge: Heffer, 1960, f. 66-67.

²⁷ *Athenaei Deipnosophistae* ..., lib. VI, 271; X 443. Dorëshkrimi i Atheneut simbas F. W. Walbank lexon në një vend ἀριῦτοι dhe në një tjetër ἀρκαδίους, ἀρκάδας. Kurse Ἀρδιαῖοι është korrigjimi i mundshëm i Casaubon. Atheneu, (shek. II. e.s.), shprehimisht thotë se të dhënat mbi skllavërinë i ka marrë prej Theopompit.

²⁸ Carl Patsch, *Die Herzegovina einst und jetzt*, Wien: 1922, f. 42.

²⁹ Marcus Iuniani Iustini, *Epitoma historiarum Philippicarum Pompei Trogi*, Lipsiae: B.G. Teubner, 1886, lib. XXIX, 4.

³⁰ *Athenaei Deipnosophistae* ..., lib. VI, 103.

është me të vërtetë domethënëse.³¹ Duket se thesalët, të mësuar për të bërë skllavë në tokat ilire më lindore në kufi me ta, të penestëve, i kanë dhënë emërtimit etnik apo fisnor të këtij populli të Ilirisë Lindore, domethënien e skllavit.

Një gjë e ngjashme ka ndodhur edhe më vonë me emërtimin sllav=skllav, saraçen= skllav, zezak=skllav. Kështu në mesin e shek. IV p.e.s shoqëria ilire ishte e ndarë qartë në klasa e shtresa shoqërore dhe njihnte format e hershme të nënshtrimit dhe shfrytëzimit skllavopronar, si e tillë ishte një shoqëri skllavopronare.³²

Luftërat iliro-romake dhe pushtimi i Ilirisë nga Roma sollën edhe pasojat e veta të pashmangshme ashtu si edhe në aspektet e jetës sociale, fetare e politike në aspektin që ka të bëjë me objektin e këtij punimi. Një numër i madh ilirësh u shndërruan në skllavë, veçanërisht robërit e luftërave iliro-romake. Jo vetëm shtresat e ulta të popullsisë dhe masa e popullsisë së skllavëruar iu nënshtrua këtij fati, por edhe krejt struktura shoqërore. Suetoni tregon për një ilir të quajtur Epikad, i cili ishte libër i Asin Polionit, që ishte me origjinë partine, dhe që mori pjesë në një komplot kundër Oktavian Augustit.³³ Të tjerë autorë kumtojnë për një Epikad tjetër, gramatikan, që ishte skllav i liruar i Sulës. Emri tipik ilir, Epikad, na çon në përfundimin se kemi të bëjmë me ilir.³⁴

Është vënë re një dobësim i fenomenit të skllavërisë ose më saktë një tronditje e këtij institucioni në shoqërinë romake duke filluar nga shek. II e.s. Si shkak i këtij procesi mund të sillen argumente të ndryshme si jorentabiliteti ekonomik i punës së skllavit në krahasim me atë të kolonit etj.³⁵ Megjithatë, autorë të shquar kanë sjellë si arsye kryesore zvogëlimin e hapësirës së furnizimit me skllavë si pasojë e frenimit të ekspansionit të mëtejshëm territorial të perandorisë si dhe vendosjen e konsolidimit e rendit romak në këtë hapësirë. Kjo *pax romana* sjell domosdoshmërisht

³¹ *Po aty.*, lib. VI, 85.

³² S. Islami, "Shteti ilir, vendi dhe roli i tij në botën mesdhetare... ", f. 93.

³³ C. Suetoni Tranquilli, *De vita XII Caesarum*, Loeb Classical Library: 1913, "Augustus", 19, 1.

³⁴ Vangjel Toçi, "Të dhëna mbi elementin ilir në Dyrrah në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike", në *Studime historike*, nr. 2, viti XXVI (IX), Tiranë: 1972, f. 105.

³⁵ Charles Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale*, vëll. I, Brugge: De Tempel, 1955, f. 44-45.

reduktimin e burimit kryesor të furnizimit me skllavër që ishin luftërat pushtuese romake.³⁶

Reduktimi i numrit të skllavërve bën që vetë Perandoria Romake të fillojë të përdorë robërit e luftës për të populluar zona apo për të përmbushur funksione që më përpara ishin privilegj vetëm i njerëzve të lirë. Kështu, në kohën e perandorit Valentinian I, rreth vitit 370, skllavër gjermanë ngarkohen që të kultivojnë tokat në brigjet e lumit Po, dhe më 378, Friderigusi, gjeneral i Gracianit, çon në zonën e Parmës, Rexhio Emilias dhe Modenës, gotë dhe robër të tjerë që vinin nga zona e Ilirikut.³⁷

Skllavërit në Antikitetin e Vonë dhe Mesjetën e Hershme: mes pronarëve dhe “barbarëve”

Zhvillim dhe përmasa të tjera mori fenomeni i skllavërisë me nisjen e dyndjeve të popujve që jetonin jashtë kufijve të Perandorisë Romake. Tabloja e përshkruar nga një autor bashkëkohës mbi ngjarjet e fundit të çerekutshekullit IV e.s. është më se e qartë:

“Më rrënoqethet trupi kur mendoj të tregoj për shkatërrimet në kohën tonë. Në vazhdim të njëzet vjetëve, bile edhe më tepër, gjaku romak derdhet për çdo ditë ndërmjet Konstantinopolit dhe Alpeve Jule: goti, sarmati, kuadi, alani, huni, vandalët dhe markomanët shkretajnë, plaçkisin dhe grabisin Skythinë, Thrakinë, Maqedoninë, Dardaninë, Dakinë, Thesalinë, Ahenë, Epirin, Dalmatinë dhe gjithë Panoninë. Sa gra fisnike, sa virgjëresha kushtuar Zotit, sa njerëz të lirë dhe fisnikë u dhunuan në këto lufta. U morën robër peshkopë, u vranë prifta dhe shërbyes të tjerë të ndryshëm të kishës. U shkatërruan kishat. Pranë altarëve të Krishtit u vendosën si në grazhd kuajt. Kockat e martirëve u nxorrën nga varret. Kudo zi, kudo ofshe dhe hija e madhe e vdekjes.”³⁸

Në kohën e perandorit Konstantini II, mbasi kishte mundur gotët u drejtua kundër sarmatëve, të cilët nuk pati nevojë të ndërmernte ndonjë

³⁶ *Po aty*, f. 40-48.

³⁷ William Blair, *An inquiry into the state of slavery amongst the Romans from the earliest period till the establishment of the Lombards in Italy*, Edimburg: T. Clark, 1833, f. 160; Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale ...*, vëll. I, f. 50.

³⁸ Eusebius Hieronymus, *Epistolae, Patrologiae, cursus completus*. Series latina. Vol. 22. Paris: Migne, 1845 bot. J.-P. Migne, vëll. XXII, 403, kol. 647.

veprim ushtarak mbasi për fatin e tij të mirë, sklllevërit e sarmatëve ngritën krye kundër të gjithë zotërinjve dhe i dëbuan. Konstantini i pranoi ata sklllevër me përzemërsi dhe i shpërndau nëpër Thraki, Skythi, Maqedoni dhe Itali me treqind mijë vetë të moshave dhe gjinive të ndryshme.³⁹

Një dëshmi tronditëse mbi përmasat që kishte marrë fenomeni i sklllavërisë në tokat ilire në mesin e shek. IV e.s, na e jep Shën Ambrozi.

“Bujaria më e madhe është që të blihen robërit, të nxirren nga duart e armikut, të shpëtohen njerëzit nga vdekja dhe më tepër gratë nga përdhunimi, t’u kthehen fëmijët prindërve të tyre dhe prindërit fëmijëve të tyre, të kthehen qytetarët në atdheun e tyre. Të gjitha këto janë të njohura nga shkretimi i Ilirikut dhe i Thrakisë. *Në qoftë se do të mblihdeshin në një vend të gjithë robërit të cilët shiten gjithkund nëpër botë, ata nuk do të mund të plotësonin numrin e robërve të njëjës nga këto provinca.*”⁴⁰

Në vitin 517, ushtritë e popullsisve, të cilat kronisti i kohës i emërton «gete», emër me të cilin bizantinët quanin gotët, por edhe sllavët dhe bullgarët, «plaçkitën deri tek Thermopylet dhe Epirin e Vjetër. Atëherë perandori Anastas, dërgoi me Paulin tek Joani, prefekt i Ilirikut, njëmijë ponde monedhash ari që të kthenin romakët e kapur robër. Meqenëse shpërblimi nuk qe i mjaftueshëm, robërit romakë u dogjën së bashku me shtëpitë e tyre ose u copëtuan para mureve të qyteteve të mbyllura».⁴¹

Njëfarë përmirësimi i situatës ndodhi me aksionin e Mundit, komandantit të këmbësisë dhe të kalorësisë ilire, i cili sulmoi gotët, të cilët kishin kohë që i binin kryq e tërthor Ilirikut, duke i përzënë dhe vrarë shumë prej tyre.⁴²

Dekadenca e përgjithshme që kishte përfshirë Perandorinë Romake u dha mundësi gjithnjë e më të mëdha popullsisve që banonin jashtë kufijve të kësaj perandorie dhe që në atë kohë quheshin «barbarë» që të depërtonin në thellësi të territoreve të përfshira në këtë perandori, pa

³⁹ Anonymi Valesiani, *Origo Costantini Imperatoris ...*, 6.

⁴⁰ Sancti Ambrosii Mediolanensis Episcopi, *De officiis ministrorum*, Patrologia Latina, bot. J.-P. Migne, Paris, 1845, vëll. XVI, lib. I, 15, 86, kol. 129 A.

⁴¹ Marcellinus Comes, *Chronicon*, bot. J. P. Migne, *Patrologia Latina*, vol. 51, Paris, 1846, viti 517.

⁴² *Po aty*, viti 530.

hasur në rezistencë të madhe. Në një klimë të tillë dekadence padyshim edhe morali i trupave ushtarake romake kishte rënë shumë keq.

Kjo dukuri nuk kishte se si të mos i përfshinte edhe popullsitë ilire. Në vitin 544-545 të gjithë trupat ilire të inkuadruara në ushtrinë romake që kishin marshuar me komandantin e tyre, Vital deri në krahinën Emilia në Itali, dhe që shkronin në rreth katërmijë vetë, «ikën papritur, fshehurazi, dhe u kthyen në shtëpitë e tyre, megjithëse nuk u kishte bërë askush dhe nuk kishin dëgjuar prej askujt ndonjë të keqe.»

Në shpjegimin që ata i bënë perandorit lidhur me dezertimin e tyre përmendnin jo vetëm pagesën e pakët që merrnin në ushtri por edhe faktin se në këtë kohë ushtria e hunëve u kishte rënë ilirëve, duke marrë robër dhe kthyer në skllevër gratë dhe fëmijët e tyre. Si morën vesh këtë dhe të lodhur nga uria në Itali, vendosën të iknin.⁴³

Mirëpo kthimi i ushtarëve ilirë nga Italia për në shtëpitë e tyre nuk e shpëtoi Ilirinë. Afërsisht në këtë kohë rreth viteve 547-548 e.s. “një ushtri skllavenësh, duke kaluar lumin Istër (Danubin), bëri shkatërrime të tmerrshme në gjithë Ilirinë deri në Epidamn (Durrës), duke vrarë dhe kthyer në skllevër të gjithë ata që u dëlnin përpara, pa marrë parasysh gjininë apo moshën, dhe duke grabitur pasurinë.» Situata ushtarake në Iliri i kishte ndihmuar me sa duket popullsitë e paorganizuarat sllave. «Shumë fortifikata që ishin këtu dhe që më përpara dukeshin të forta, meqenëse nuk i mbronte njeri, skllavenët mundën t’i marrin; ata u përhapën nëpër krahina, duke bërë shkretime fare lirisht. Komandantët e Ilirisë i ndiqnin nga mbrapa, me një ushtri prej pesëmbëdhjetë mijë vetësh, por në asnjë vend nuk vendosën t’u afrohen”.⁴⁴

Gjatë luftës me gotët, këta në vitin e katërmëdhjetë të saj, pra rreth viteve 548-549 arritën të thyenin ushtritë romake dhe të pushtonin gjithë Italinë ndërsa «Iliria dhe Thrakia iu nënshtruan grabitjes dhe asgjësimit pa asnjë mëshirë nga ana e barbarëve, meqenëse ata ishin fqinjë të këtyre vendeve».⁴⁵

Nuk ishin vetëm hunët, gotët dhe sllavët që shkretinin lirisht krahinat ilire, por këtyre iu shtoheshin edhe popullsi të tjera, siç ishte

⁴³ Procopii Caesariensis, *Historiarum temporis sui de bello gothico*, Munchen: G. Franzius, 1854. lib. VII, 11.

⁴⁴ *Po aty*, lib. VII, 29.

⁴⁵ *Po aty*, lib. VII, 33, 1.

rasti i longobardëve, të cilët ishin vendosur nga vetë Perandoria Romake brenda kufijve të saj, me qëllim që këta ta mbronin perandorinë nga «barbarët» e tjerë. Këtyre, perandori Justinian u fali qytetin Norik, disa kështjella në Panoni dhe në shumë zona të tjera, e përveç kësaj u paguante edhe shuma të mëdha në këmbim të «mbrojtjes».

Të joshur nga këto privilegje longobardët lanë vendin e tyre dhe u vendosën në breg të Danubit, në afërsi të zonave të banuara nga populli tjetër «barbar» i gepidëve. Këta të fundit «grabitnin Dalmatinë dhe Ilirinë, deri në kufijtë e Epidamnit, dhe banorët i kthenin në skllëvër. Por kur disa prej robërve mundën t'u shpëtonin dhe të kthehen në atdhe, barbarët duke përshkuar gjithë Perandorinë Romake, si aleatë të romakëve, po të njihnin këtu ndonjë nga të arratisurit, i zinin ata si të ishin skllëvër personalë të ikur dhe duke i shkëputur nga gjiri i prindërve, i merrnin me vete, sepse për këtë nuk i pengonte asnjëri.»⁴⁶

Lista e gjatë e popullsive «barbare» që shkretinin tokat ilire dhe ushqeheshin me gjak ilir nuk mbaron me kaq. Paaftësia e perandorisë për të mbrojtur vetveten solli pasojat e veta të rënda. Tashmë as aleatët të cilëve u paguante shuma të mëdha parash nuk i qëndronin besnikë dhe nuk e respektonin fuqinë romake. Kështu «me lejen e perandorit vende të tjera të Dakisë, rreth qytetit Singidon, i zunë erulët- ata edhe tani jetojnë këtu; edhe këta e sulmonin Ilirinë dhe vendet kufitare me Thrakinë, dhe shkretinin hapësira të gjera të tyre».⁴⁷

Prej këtyre popullsive ajo që më shumë shkretoi dhe solli mjerim në Iliri ishin sllavët. Shoqëria romake dhe ilire ishte aq e tronditur, në dekadencë të thellë morale, dhe në pështjellim aq të madh sa që edhe ushtri fare të vogla e të paorganizuar të këtyre popujve korrnin fitore të lehta e të bujshme mbi legjionet romake.

Këtë e dëshmoi disfata e pësuar nga kjo ushtri një vit më vonë (549-550), kur një ushtri sllavësh, e përbërë prej jo më shumë se tremijë vetësh, kaloi lumin Istër (Danubin), pa gjetur kundërshtim nga asnjë anë, dhe pastaj, si kaloi pa vështirësi të madhe lumin Hevr, u nda në dy pjesë. Komandanti i ushtrisë romake në Iliri dhe Thraki hyri në luftë me këtë ushtri dhe megjithëse ajo ishte e ndarë në dy pjesë, romakët u thyen për

⁴⁶ *Po aty*, lib. VII, 33, 10-12.

⁴⁷ *Po aty*, lib. VII, 33, 13.

shkak të sulmit të tyre të papritur, disa prej tyre u vranë, të tjerët ikën me rrëmujë.

Pasi komandantët romakë u thyen në këtë mënyrë nga të dy njësitë «barbare», megjithëse ishin në numër më të vogël se romakët, njëra nga njësitë u përlesh në betejë me Asbadin, i cili ishte luftëtar nga reparti i besnikëve të perandorit Justinian, që përfshihej në listën e të ashtuquajturve kandidatë për perandorë, dhe komandonte kalorësinë e rregullt, e cila prej kohësh e kishte qendrën në kalanë thrake Tzurula, dhe përbëhej nga kalorës të shumtë, të zgjedhur. Skllavenët i vunë përpara edhe këta pa vështirësi të madhe dhe në kohën e kësaj tërheqje të turpshme, vranë shumë prej tyre, kurse Asbadin e zunë rob, pastaj e vranë duke e hedhur në zjarr, pasi i kishin rrjepur më parë lëkurën e kurrizit. Pas kësaj ata filluan të grabisin pa frikë të gjithë këto vende edhe në Thraki, në Iliri dhe shumë kështjella njësitë e skllavenëve i morën me rrethim. Më parë skllavenët nuk kishin guxuar asnjëherë t'u afroreshin mureve ose të dilnin në fushë (për luftë të hapët), sepse këta barbarë s'kishin provuar më parë të kalonin në tokën e romakëve.⁴⁸

Suksesi i kësaj pararoje sllave ndaj ajkës së ushtrisë perandorake në Thraki, duket se shërbeu si joshje për ta, të cilët pa kaluar viti dynden sërish rreth viteve 551-552. «Një turmë e madhe skllavenësh u derdh në Iliri dhe bëri atje tmerre të papërshekruara. Perandori Justinian dërgoi kundër tyre një ushtri, në krye të së cilës, krahas me të tjerët, ishin edhe djemtë e Germanit. «Megjithatë këta barbarë bënë shkatërrime të tmerrshme. Në kohën e kësaj dyndjeje grabitqare, duke qëndruar brenda kufijve të perandorisë për një kohë të gjatë, ata mbushën rrugën me grumbuj trupash; morën robër dhe kthyen në skllavë një numër të madh njerëzish dhe grabitën çdo gjë që mundën; meqënëse askush nuk i luftoi, ata ikën me gjithë plaçkën në vendin e tyre».⁴⁹

Ky sukses i madh i turmave sllave kundër ushtrive perandorake mbështetej jo aq në forcën e tyre se sa në dobësinë e ushtrisë romake, dhe po ashtu po aq në grindjet e brendshme të shoqërisë ilire të kohës. Në

⁴⁸ *Po aty*, lib. VII, 38.

⁴⁹ Procopii Caesariensis, *De bello gothico*, lib. VIII, 25, 1, 2, 3, 4.

vend të luftës kundër pushtuesve që shkretinin gjithçka, ata ishin përfshirë në luftë vëllavrasëse.⁵⁰

Situata e sulmeve barbare u rëndua më tej gjatë sundimit të Justinianit. “Që kur Justiniani mori në dorë shtetin e romakëve hunët, skllavenët dhe antët janë dyndur pothuajse çdo vit në Iliri si dhe në të gjithë Thrakinë. Në tokat që shtrihen nga gjiri i detit Jon deri në lagjet e jashtme të Byzantit- ndërmjet këtyre gjenden Hellada dhe Heronezi kanë kryer akte të padëguara kundrejt banorëve të këtyre vendeve. Besoj se në çdo dyndje ka pasur më shumë se dyqindmijë romakë të vrrarë ose robër dhe të gjitha këto vende u bënë aq të shkreta sa edhe shkretëtirat e Skythisë.”⁵¹

Popullsia vendase ilire e trake ishte vendosur mes dy zjarresh. Nga njëra anë ishin sllavët me «barbarët» e tjerë dhe nga ana tjetër ishte pushteti perandorak. Perandorët të trembur për të ardhmen e tyre u linin dorë të lirë sllavëve që të shkretinin tokat ilire, madje, arrinin deri aty sa të ndëshkonin edhe ata që guxonin të vetëmbroheshin. Kjo liri dhe këto lëshime pushteti perandorak i bënte me qëllimin për t’i mbajtur popullsitë që dyndeshin në Ballkan, sa më larg kryeqytetit.

Këtë politikë kapitulluese e ndiqte edhe një perandor energjik si Justiniani, i cili duke parë se popullsia trake dhe ilire e ndihmuar nga komandantët e thrakëve dhe të ilirëve i sulmonin në tërheqje popullsitë e dyndura, urdhëroi që komandantët ushtarakë dhe popullsia vendase t’i ndërprinin sulmet. Këta morën letra nga perandori Justinian, me të cilat njoftoheshin të mos sulmonin barbarët, sepse ata ishin të nevojshëm të mbaheshin si aleatë të romakëve, qoftë kundër gotëve, qoftë kundra disa armiqve të tjerë.

“Dhe që prej kësaj kohe këta barbarë, duke u sjellë si armiq, plaçkitnin dhe merrnin robër romakët e këtushëm dhe, si miq e aleatë të romakëve i sillnin në vendin e tyre, bashkë me plaçkën dhe robërit. Shpesh disa nga fshatarët e këtushëm, të zemëruar pse u kishin rrëmbyer gratë dhe fëmijët, mbledheshin që të gjithë dhe, duke sulmuar ata që

⁵⁰ “Pjesa më e madhe e ushtrisë së dërguar nga Justiniani për luftën kundër sllavëve u ndal “me urdhër të perandorit në Iliri, afër qytetit Ulpiana, për shkak të kryengritjes së banorëve prej mosmarrëveshjeve që i shtynë të krishterët të luftojnë njëri kundër tjetrit”. *Po aty*, lib. VIII, 13.

⁵¹ Procopii Caesariensis, *Historia quae dicitur arcane*, 18.

tërhiqeshin, vrisnin shumë prej tyre dhe shtinin në dorë kuajt bashkë me gjithë plaçkën; por nga kjo ata u gjetën para vështirësive serioze. Disa të dërguar nga Bizanti, pa ngurruar kërkonin që ata të rriheshin, të torturoheshin dhe të gjobiteshin me të holla deri sa të kthenin të gjithë kuajt, që u kishin rrëmbyer barbarëve.”⁵²

Popullsia ilire nuk kërcënohej të skllavërohej vetëm nga turmat e popullsisë «barbare», por edhe nga vetë nëpunësit dhe qeveritarët romakë të cilët shfrytëzonin mjerimin dhe shkretimin e mbjellë nga popullsitë «barbare» për të shtuar kontingjentin e skllavëve të tyre me ato ilirë apo për t’i shitur kundrejt fitimeve të majme. Ky abuzim i autoriteteve romake me situatën e turbullt të krijuar si pasojë e depërtimit të popullsisë “barbare”, mori përmasa të tilla të mëdha në fundin e shek. IV dhe fillimin e shek. V e.s. sa që u trajtua në një ligj të veçantë të Kodeksit të Teodosit. Ky ligj është dekretuar nga perandori Honor (395-425) dhe mban datën 10 dhjetor 408. Perandori Honor i drejtohet Teodorit, prefektit të Ilirisë dhe Italisë, ku thuhet:

“Meqënëse në krahinat e Ilirikut pritej një inkursion barbar,⁵³ një popullsi shumë e madhe vendase kërkoi strehim jashtë vendeve të tyre të lindjes. Zakonisht kundër prejardhjes së tyre të lirë drejtohet vazhdimisht lakmia e zyrtarëve dhe u vihet atyre në mënyrë të paligjshme zgjedha e robërisë. Dhe kështu le ta dijë madhëria jote urdhërin, se nuk duhet lejuar që të vihet dorë tek gjithë ata ilirë, të cilët i strehon toka amtare ose i ka pranuar ndonjë vend tjetër.”⁵⁴

Zyrtarët dhe nëpunësit romakë në tokat ilire bëheshin shpesh objekt të ligjeve dhe dekreteve të veçanta të lëshuara nga vetë perandorët. Në njërin prej këtyre dekreteve del qartë statusi i ulët i skllavit në Ilirik si edhe krahasimi i tij me kafshët e punës. Në dekretin e perandorit Valentinian I (364-375), të datës 30 shtator 368 (373?), drejtuar Probit, prefekt i Ilirisë, kërkohet ndëshkimi i nëpunësve të cilët abuzonin me fshatarët duke i marrë dhe duke përdorur “për shërbimet dhe nevojat e veta qoftë skllavin, qoftë edhe kaun e tij”.⁵⁵

⁵² *Po aty*, 21.

⁵³ Është fjala për fushatën e Alarikut në Itali, ku kaloi nëpërmjet Ilirikut.

⁵⁴ *Codex Theodosianus*, ed. Theodor Mommsen, Paul M. Meyer, Berlin: Weidemann, 1905, lib. X, 10, 25.

⁵⁵ *Po aty*, lib. XI, 11, 1.

E gjendur në një situatë të tillë të vështirë, mes sulmeve barbare dhe abuzimeve e ndëshkimeve perandorake edhe morali i popullsisë ilire shkon natyrshëm duke rënë në një shkallë të ulët. Dëshmitë e autorëve të ndryshëm nxjerrin në pah një krizë të thellë e të gjithanshme morale që kishte pllakosur popullsinë e mjeruar ilire. Një shembull i kësaj është një mënyrë krejt e veçantë e skllavërimit, e cila dëshmohet nga legjislacioni i kohës në Ilirinë e fillimit të shek. IV e.s. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me skllavërimin e njerëzve si pasojë e luftës, të piraterisë apo konflikteve të ndryshme, por me shitjen e fëmijëve si skllavë nga vetë prindërit e tyre. Aq më tepër nuk bëhet fjalë për fëmijë të lindur skllavë dhe për prindër të tillë, por kemi të bëjmë me fëmijë të cilët kanë lindur të lirë nga prindër të lirë dhe që skllavërohen për qëllime fitimi apo mbijetese nga vetë prindërit e tyre.⁵⁶ Në raste të tjera prindërit, të cilët nuk mund të paguanin taksat ndaj shtetit detyroheshin të shisnin fëmijët e tyre.⁵⁷

Në disa raste autoritetet perandorake dhe kishtarë mundohen të luftojnë fenomene të tilla, por megjithatë kjo praktikë vazhdon të funksionojë, sidomos kur bëhet fjalë për fëmijët e porsalindur (*sanguinolenti*).⁵⁸

Në kodeksin e ligjeve që njihet si Kodeksi i Justinianit, por që në fakt është një përmbledhje ligjesh e perandorëve të ndryshëm, të cilët u kodifikuan nga perandori Justinian, një ligj i veçantë titullohet «Për baballarët të cilët kanë shitur fëmijët e tyre». Ligji në fjalë është dekretuar në Serdikë më 18 gusht 329 e.s., nga perandori Konstandini i Madh, dhe i drejtohet banorëve të provincës së vet.⁵⁹ Në të thuhet se “nëqoftëse ndonjëri për shkak të varfërisë dhe të nevojës shumë të madhe, ose për

⁵⁶ *Codex Theodosianus*, vëll. II, f. 139: «Notum est proxime obscaenissimam famem per totam Italiam desaevisse cunctosque homines filios et parentes vendere, ut discrimen instantis mortis effugerent?»

⁵⁷ Kjo dukuri ndodhte edhe si rrugëdalje në rast se prindi nuk mund të paguante taksat ndaj perandorisë. Hieronymus, *Vitae Paphnutii*, sipas Friedrich Affolter, *Die Persönlichkeit des herrenlosen Sklaven. Ein Stück aus dem Römischen Sklavenrecht*, Leipzig: Veit, 1913, f. 55.

⁵⁸ *Codex Theodosianus*, V. 10: «de his qui sanguinolentos emptos vel nutriendos acceperint.» Në këtë rast duhej të nënshkruhej një dokument zyrtar. Blerësi kishte të drejtën e pronësisë, por jo *jus distrahendii*. Vetëm i ati kishte të drejtën për të rimarrë fëmijën e shitur. (Bot. Mommsen-Meyer, vëll. I, 2, f. 226).

⁵⁹ Konstandini i Madh, lindi dhe u rrit në qytetin e Naisus (Nishi i sotëm). Anonymi Valesiani, *Origo Constantini Imperatoris ...*, 2.

mungesë ushqimi ka shitur të birin ose të bijën, duke qenë këta foshnje të posalindur, vetëm në këtë rast shitja është e vlefshme dhe blerësi ka mundësi ta mbajë atë si skllav”. Por, le t’i lejohet atij që e ka shitur ose ia ka dhënë të tjerëve ose kushdo qoftë tjetër të kërkojë lirimin e tij, mjaft që të caktojë çmimin që mund të kushtojë ose të paraqesë një skllav të njëlojtë me të.⁶⁰

Ky fenomen rreth dy shekuj më vonë kishte marrë një nuancë tjetër më të sofistikuar. Shumë prindër duke mos pasur mundësi të blejnë skllavë për shkak të pamundësisë financiare, kishin shpikur një praktikë që edhe për bashkëkohësit konsiderohej e turpshme, mbasi duket se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me prindër të ndodhur përballë sfidës së mbijetesës dhe që detyrohen të shesin fëmijët e tyre për të mbajtur frymën gjallë. Praktika, e cila duket se kishte marrë përhapje jo të vogël në zonat e Ilirikut dhe të krahinave fqinje ishte padyshim pasqyrim i degradimit shpirtëror dhe moral në të cilën kishte rënë shoqëria romake e asaj kohe, dhe krahinat ilire si pjesë të kësaj shoqërie.

Kjo praktikë ishte aq djallëzore dhe e sofistikuar sa që nëpërmjet saj prindërit që nuk mund ta kishin luksin e të pasurit skllavë, në krye të disa viteve arrinin që përmes një procesi gjyqësor, fëmijën të cilin e kishin braktisur që foshnje dhe si i tillë u ishte besuar institucioneve kishtarë për ta rritur e edukuar, apo ishte adoptuar nga persona të ndryshëm, ta rimerrnin duke reklamuar të drejtën prindërore ndaj tyre. Kur përmes gjyqit e rimerrnin fëmijën që e kishin braktisur përpara disa viteve,⁶¹ këta prindër, duket se në këtë mënyrë e thyenin pengesën psikologjike që do të nënkuptonte skllavërimin e fëmijës së vet, prej faktit se qëllimisht i kishin larguar fëmijët nga prehri i tyre. Kjo mungesë e afrimitetit prind-fëmijë bënte që ata ta kishin ndërgjegjen më të qetë kur kryenin aktin e rimarrjes së fëmijës tashmë të edukuar nga të tjerët dhe të skllavërimit të tij.

⁶⁰ *Codex Justinianus...*, lib. IV, 43.2.

⁶¹ Në këtë rast për të rimarrë fëmijën e tyre me qëllim për ta pasur atë si skllav, këta prindër mbështeteshin në të drejtën romake të kohës, e cila nuk i konsideronte këta fëmijë të shitur nga prindërit e tyre si skllavë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, sepse përpara ligjit ata nuk kishin nevojë që të liroheshin nga pronarët e tyre për t’u bërë të lirë. Mjaftonte që për ta të paguhej çmimi i lirit dhe pasi fitonin lirinë konsideroheshin si *ingenui*, dhe jo si *liberti*. F. Affolter, *Die Persönlichkeit ...*, f. 65.

Shohim në këtë praktikë se prirja hedoniste, pra për të kënaqur vetveten kishte mbërritur nga shtresat e larta dhe kishte përfshirë edhe njerëzit e thjeshtë. Asgjë nuk i ndalte njerëzit e kësaj periudhe të turbullt drejt synimeve të tyre për kënaqësi personale, madje për të arritur këtë kënaqësi sakrifikonin edhe fëmijët e tyre. Shkalla e imoralitetit që mund të shihet tek kjo praktikë bëhet akoma më e qartë po të kemi parasysh që djali apo vajza i skllavëruar nga prindërit e tyre, në se mund të quhen me këtë emër, duke u shfrytëzuar dhe trajtuar si skllavë, dhe padyshim edhe praktikatat inçestuale ishin normale në këtë situatë.

Lirimi, një aventurë më vete

Në parim skllavërit zakonisht kishin të drejtën për t'u liruar kundrejt pagesave të caktuara. Ky lirim në rastin e robërve të luftës apo viktimave të grabitjeve në det e në tokë, shpesh ishte rezultat i negociatave ndërmjet fuqive të interesuara. Ai bëhej përmes shkëmbimit të robërve apo përmes një pagese të caktuar për të cilën bihej dakord. Historia ka plot shembuj të negociatave të tilla, herë të dështuara, herë të kurorëzuara me sukses. Këto negociata ka raste që bëheshin ndërmjet përfaqësuesve zyrtarë të një shteti, por ka edhe mjaft raste të tjera që bëheshin nëpërmjet ndërmjetësish që paguheshin për atë punë nga të afërmit apo familjarët e robërve. Gjithashtu edhe urdhrat fetarë, me rrjetin e gjerë të informacionit që kishin, me mundësitë që zotëronin si edhe me imunitetin që shpeshherë ishte një privilegj i veçantë për ta, bënë shumë punë në lirimin e robërve.

Fati i keq i ndiqte skllavërit edhe mbasi fitonin lirinë aq shumë të ëndërruar. Edhe ajo pjesë e vogël që kishte fatin të arrinte lirimin nga pronari, nuk kishte arritur akoma lirinë e mëparshme. Zakonisht skllavërimi e ndryshonte rrënjësisht dhe përgjithmonë jetën e njerëzve. Edhe lirimin kishte vështirësitë e veta. Skllavërit e liruar ishin shumë pak të begenisur në shoqërinë ku kishin qëndruar si skllavë, nga ana tjetër, mungesa e gjatë nga vendi i tyre, praktikisht e bënte shpesh të pamundur riintegrimin e tyre në shoqërinë e vendlindjes.

Nami i keq dhe përçmimi i ndiqte edhe mbas liriminit. Kështu, në Romë, skllavërit e liruar shiheshin me mosbesim dhe përbuzje. Ata mbasi liroheshin nuk bëheshin kurrë më njerëz të lirë, por të liruar. Suetoni duke folur për jetën e Jul Cezarit, thotë se ai futi në rradhët e ushtrisë “skllavë të liruar vetëm dy herë në jetën e tij: përveç shërbimit në Romë,

kur binte zjarr dhe kur kishte frikë se mos plasnin turbullira për arsye të shtrenjtimit të drithit- një herë për t'i vendosur si garnizon në kolonitë kufitare me Ilirikun dhe herën e dytë për të mbrojtur brigjet e Renit”.⁶²

Nga ana tjetër, plagët e skllavërimit ishin shumë të vështira për t'u shëruar. Në Romë, një skllav që kishte fituar të drejtën e qytetarisë romake si pasojë e lirit, por që më përpara se të skllavërohej kishte qenë njeri i lirë i një shteti tjetër, ligji romak i njihte të drejtën që të kthehej në dheun e vet si njeri i lirë, por në rast se ky shtet ishte tributar ndaj Romës, ky kthim vështirësohej prej faktit se, në rast kthimi në dheun e vet, personi në fjalë e humbiste qytetarinë romake.⁶³

Në se një skllav ishte liruar nga një pronar në Venedik, ai mbetej aty, me shumë pak mundësi për t'u kthyer në vendlindje. Zakonisht kur liroheshin nuk posedonin jo vetëm asnjë pronë të tyre, por madje, as të holla. U duhej të nisnin gjithçka nga e para, pa familje, pa shoqëri dhe shpesh nuk ia dilnin të përballonin jetën e vështirë dhe të pashpresë.

Të liruarit në të gjitha qytetet ndihmoheshin ndonjëherë edhe nga kuvendet, urdhrat e ndryshëm fetarë, por më së shumti ndihmonin njëritjetrit dhe nga bashkimet që grumbullonin rreth vetes skllavë të liruar të së njëjtës origjinë etnike. Në këtë mënyrë e ndjenin dhe e pësonin më pak vetminë e tyre në gjirin e qyteteve italiane apo iberike. Mundoheshin gjithashtu që të ruanin ndonjë traditë të vendlindjes, të mbështetur në kujtesën e një gjuhe të përbashkët, në devocionin ndaj këtij apo atij shenjt, pra në festat dhe kremtimet e festuara bashkarisht.

Në Gjenovë gjatë mesjetës, skllavërit e liruar nga Lindja, ku pjesën më të madhe e përbënin grekët, kishin themeluar një *Consortia libertinorum seu grecorum*, në lagjen në afërsi të qendrës së qytetit. Fjala Consortia nënkupton qartë një “shoqëri”, çka don të thotë se ishte një mënyrë ndihme dhe mbështetjeje për anëtarët e vet jo e karakterit patriarkal, por konfraternal. Po ashtu, në Barcelonë ekzistonte një

⁶² C. S. Tranquilli, *De vita Caesarum ...*, lib. II, 25.

⁶³ Marcus Tullius Cicero, *Ciceronis pro Archia et pro Balbo orationes*, tr. by C.H. Crosse, Cambridge, 1879, 12, 29. Për më tepër lidhur me këtë situatë të ndërlikuar shih: Théodore Mommsen, *Le droit public romain*, t. VI, Ernest Thorin editeur, Paris: 1889, f. 58.

Cofradia des negros libertos, e cila bashkonte në gjirin e vet sklllevërit zezakë të liruar.⁶⁴

Natyrisht historia njeh edhe shembuj të sklllevërve të liruar të cilët nëpërmjet aftësive të tyre si edhe të mbrojtjes e mbështetjes nga ish-pronarët e tyre të fuqishëm kanë mbërritur në pozita të rëndësishme. Një nga këta shembuj është edhe ai i perandorit romak me origjinë ilire, Diokletianit. “Diokletiani dalmatas, libert i senatorit Anulin, para se të merrte sundimin quhej Diokles, emër të cilin e kishte nga e ëma dhe njëkohësisht nga qyteti Diokle, por kur mori fuqinë e shtetit romak e ndërroi emrin në Graj, sipas zakonit romak dhe sundoi 25 vjet”.⁶⁵

Kushtet e rënda të skllavërisë, dhe vetë statusi i ulët ose më saktë i papërfillshëm shoqëror i sklllevërve, bënte që shumë prej tyre të ëndërronin dhe të përpiqeshin për të arritur lirinë përmes liriminit nga vetë pronarët e tyre, apo nga autoritete të caktuara. Mirëpo, pa dyshim që ka pasur shumë prej sklllevërve të cilët të etur për të qenë të lirë, nuk prisnin liriminit nga pronarët e tyre. Por, gjithsesi edhe këta, ëndrra për liri i shtynte të ndërmerrenin një hap që ka rezultuar gjithmonë i rrezikshëm dhe ka qenë rreptësisht i ndëshkuar në të gjitha shoqëritë që në një mënyrë apo në një tjetër e kanë pranuar skllavërinë. E kemi fjalën për çlirimin nga skllavëria, qoftë përmes arratisjes, qoftë përmes revoltave të organizuara.

Në krahinat e populluara me kolonë ilirë, pra në Ilirik, perandori Valentinian me dekretin e datës 15 korrik 371 e.s. ndëshkonte ato kolonë në krahinat e cituara të cilët pranonin sklllevër.⁶⁶ Në këtë rast kemi të bëjmë me një dekret që synonte kufizimin e përdorimit të sklllevërve në punët e ndryshme.

Skllavërimi si çdo plagë linte pasojat e veta në jetën e sklllevërve edhe në se ata ia dilnin të liroheshin. Gjithmonë ata cilësoheshin si “të liruar”, të cilët shoqëria i dallonte si njerëz që dikur kishin qenë sklllevër. Pasojat e një plage të tillë, si skllavërimi, shpesh nuk i shëronte as lirimi nga skllavëria.

⁶⁴ Jacques Heers, *Esclaves et domestiques au Moyen Age dans le monde méditerranéen*, Paris: Fayard, 1981, f. 275.

⁶⁵ Sexti Aureli Victoris, *Liber de Caesaribus*, München: Straub, 1892, lib. III. 39.

⁶⁶ *Codex Justinianus*, lib. XI, 53, 1. «Për kolonët ilirë».

Shën Ambrozi pohon për skllëvërit ilirë, të cilët robëroheshin përditë nga popullsitë barbare dhe nga spekulatorët romakë, se “kishte, megjithatë, nga ata që i çlironte kisha, të cilët dëshironin të ktheheshin në skllavëri, që ishte më e rëndë se robëria, sepse e urrenin mëshirën e huaj”.⁶⁷

S u m m a r y

SLAVERY IN THE ALBANIAN TERRITORIES DURING THE LATE ANTIQUITY AND EARLY MIDDLE AGES

Slavery compounds a world historic phenomenon that has affected all the continents, sometimes at the same time or one after another. The slavery sources in the antiquity and in the Middle Ages were a lot, but was overwhelming the slavery as consequence of different conflicts and wars. The question of slavery among the Illyrians has occupied little space in the papers of the different authors within the ancient Albanian territories, nonetheless the slavery in antiquity has been one of the most important social structures of the time directly connected with the production relations. Usually the slavery drastically and forever changed the people's life, but the bad luck chased the slaves even after winning so much dreamed freedom. Also the freedom had the proper difficulties, especially about the integration of the liberated slaves in the society. Thus, in Rome, the liberated slaves were seen with disbelief and contempt. They after being liberated never became free men, but liberated. The hard conditions of slavery, and the low social status of the slaves, made that many of them dream and try to escape to achieve the freedom not only through liberation from their owners, but even through escape or organized rebellions. The development and other dimensions carried the slavery phenomenon with the invasion of the peoples living outside the borders of the Roman Empire, directly influencing in the situation of the population that after that would face the age of the early Middle Ages.

⁶⁷ Sancti Ambrosi, *De officiis ministrorum*, lib. I, 15, Patrologia Latina, vëll. XVI, bot. J.-P. Migne, 86, kol. 129 A.

